

E drejta pronësore - një nga 'Standardet për Kosovën'

Nga Zenun Pajaziti - Koordinator i Qeverisë Për Standardet

Një fushë e ndjeshme që theksohet me probleme të ndryshme në Kosovë padyshim është edhe prona. Ne ende nuk kemi mundur të sigurojmë mbrojtje të mjaftueshme ligjore e institucionale për pronën. Kur kësaj i shtojmë edhe problemet tjera pas lufte, si dhe çështjen e privatizimit të pronës shoqërore e publike, kjo çështje mbetet si më problematike tek ne.

Poashtu mungesa e të dhënave të tërësishme mbi pasuritë e patundshme e vështirëson edhe më shumë procesin e mbrojtjes së të drejtave pronësore. Në këtë drejtim, Qeveria e Kosovës po angazhohet në avansimin e shërbimit kadastral për t'u siguruar një bazë e konsoliduar e transakcioneve pronësore dhe atyre poseduese.

Baza ligjore ekzistuese nuk ka mundur t'i parandalojë tërësisht fenomenet që kanë dëmtonuar pasuritë e patundshme të qytetarëve. Në Kosovë ka edhe disa vendbanime jozyrtare të banuara me bashkësi të cilat ndihen të rrezikuara. Të gjithë këto kanë bërë që standardi për të drejtën e pronës të fokusohet në katër elemente me të rëndësishme:



Pristina, kryeqyteti i Kosovës/Fotografia: Hasan Sopa

- zbatim dhe aftësim efektiv;
- koordinim dhe bashkëpunim;
- zhvillim të ligjeve dhe qasje strategjike; dhe
- kompletim të të dhënave.

Fillimisht duhet të themelohet një grupi ekspertëve i cili do të përfshijë edhe vendorë edhe ndërkombëtarë. Roli i këtij grupi do të jetë që të ndihmojë koordinimin, zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave pronësore juridike.

Ne tashmë i kemi evidencuar shumicën e ligjeve që janë theksuar në 'dokumentin e standardeve' ndërsa grupi për të drejtën pronësore do të fokusohet në ligjet e pronës dhe do të angazhohet që këto ligje të realizohen sa më shpejtë me procedurat e nevojshme.

Prona për qytetarin është e shenjtë. Ne duhet t'u sigurojmë atyre mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Kjo është një punë jo e lehtë për këtë fazë por e domosdoshme për t'u bërë. Qeveria e Kosovës ka fokusuar veprimet e saja edhe në këtë drejtim dhe së shpejti do të jemi dëshmitarë të sukseseve të dukshme. Por ka nevojë në shoqërinë tonë për angazhim më të gjithanshëm të të gjithë faktorëve dhe një bashkëpunim më të mirë. Trajtimi më i mirë dhe avansimi ligjor e institucional i së drejtës së pronës do t'i shërbejë për të mirë zhvillimit dhe demokratizimit të mëtejshëm të Kosovës.

Le të angazhohemi të gjithë për këtë.

NË KËTË NUMËR

Pronarët pa shtëpi f. 3


**Errësira buzë qytetit:
Mahalla e romëve** f. 4

**Mësimet nga Bosnia dhe
Hercegovina** f. 6

**Shokët e pazakonshëm:
Ata që shpëtuan manastirin** f. 8

Një detyrë e institucioneve tona, si dhe e mekanizmave ndërkombëtarë këtu, mbetet angazhimi në parandalimin e posedimit apo shfrytëzimit të paligjshëm të pronës. Ne tashmë i kemi identifikuar një numër të caktuar të detyrave që dalin nga Dokumenti për Standarde e që duhet të zbatohen nga kuvendi i Kosovës, qeveria, komunat, gjykatat, etj.

Pjesa kryesore e veprimeve që duhet të ndërmerren për ta ruajtur pronën dhe për ta respektuar të drejtën pronësore duhet të bëhen nga mekanizmat të cilët kanë të drejta të rezervuara në Kosovë. Përpjekjet e Institucioneve tona të deritashme nuk kanë munguar, por ato kanë qenë të kufizuara në marrjen e vendimeve adekuate. Nganjeherë është krijuar përshtypja se efekti i tyre ka të bëjë më shumë me ngritjen e vetëdijes të qytetarët se sa në marrjen e masave konkrete. 'Dokumentin e standardeve' do ta imponojë edhe një bashkëpunim më të mirë të IPVQ-së dhe UNMIK-ut që të punojmë më tepër në këtë drejtim.



Të dashur lexues

Të drejtat pronësore na tingëllon sikur diçka që nuk ka nevojë për brengosje – ka të bëjë me atë që mund ta gjejmë në konventat ndërkombëtare. Është një problem që i takon dikujt tjetër. Por ju me siguri se bisedoni për këtë çështje dhe tërë kohën frustroheni.

Me siguri se ju bisedoni me të afërmit dhe me shoqërinë tuaj për blerjen apo posedimin e një shtëpie apo apartamenti për familjen tuaj. Ose ndoshta doni të filloni biznes për mbështetjen e familjes dhe nevojën për të pasur hipotekë në pasurinë tuaj. Ose ju mund të ankoheni te shokët

tuaj se dikush në mënyrë ilegale ka bërë ndonjë ndërtim në pronën tuaj dhe ju nuk jeni në gjendje që t'i ndaloni. Apo ju mund të ankoheni se rrugët, shkollat, ose spitalet në komunitetin tuaj nuk janë fare të përshtatshme. Do të thotë ju po bisedoni për çështjen e të drejtës pronësore. Çështja e të drejtës pronësore ka të bëjë me jetën

e përditshme. Ka të bëjë me mundësinë për të poseduar një shtëpi për familjen tuaj, ose dhënja apo marrja me qira e një lokali me qëllim biznesi, ose të mbjellësh kultura bimore në tokën tuaj duke mos lejuar që dikush të ndërtojë aty një pompë të benzinës.

Shfrytëzimi i të drejtës mbi pasurinë tuaj – e drejta tuaj ligjore për të blerë, shitur ose shfrytëzuar tokën ose ndërtesat – është mjeti kyç për zhvillimin dhe përparimin ekonomik të Kosovës. Gjithashtu është e rëndësishme për qeverinë që të ju mundësojë qasje në shërbimet për të cilat keni nevojë dhe të bëjë përmirësimin e standardit të jetesës. Autoritetet komunale dhe qëndrore duhet të kenë pronë për ndërtimin e shkollave, spitaleve dhe rrugëve, në mesin e gjërave tjera.

Por në Kosovë, e drejta pronësore nuk mund të ushtrohet plotësisht. Një nga arësyet është se dokumentacioni ligjor për poseduesit e pronës – të dhënat për pasurinë e patundshme janë të papërfunduara, ka mangësi, ose janë të vjetëruara. Arësyet tjetër është se aktualisht, qeveria nuk është në gjendje që të mbrojë të drejtën pronësore nga shpërdorimet, as përmes gjykatave, policisë, as përmes strukturës administrative komunale.

Si rezultat i kësaj, në mënyrë ilegale janë okupuar shtëpitë, tokat bujqësore ose janë shrytëzuar apo kultivuar për qëllime jobujqësore, dhe njerëzit ndërtojnë kudo që dëshirojnë, pa leje ndërtimi, kjo do të thotë se ka shumë ndërtime ilegale në toka të tjerëve, dhe infrastruktura, siç është kanalizimi, uji, dhe rryma janë të stërnrgarkuara. Kjo gjithashtu do të thotë se komunat nuk mund të planifikojnë zhvillim ekonomik të komunitetit,

sepse ata nuk e dijnë se kush e posedon pronën, as nuk mund të presin nga banorët të respektojnë marrjen e vendimeve. Momentalisht në Kosovë, është një përshtypje e mosndëshkimit në lidhje me të drejtën pronësore.

Në fakt, e drejta pronësore është gjithashtu shumë e rëndësishme për mundësimin e kthimit dhe integritetit të minoriteteve në Kosovë.

Përmirësimi i jetës së përditshme do të thotë përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave pronësore dhe promovimi i respektit për të drejta pronësore në mes jush, shokëve, fqinjëve, dhe qeverisë. Kjo është ajo që standardi për të drejta pronësore/trashëgimisë kulturore dhe plani për implementim të tyre është për t'iu ndihmuar juve dhe Kosovës.

Standardet dhe plani për implementim kërkon veprime për sigurimin e një regjistri të saktë për të drejtën e pronës së patundshme, kështu që ju të mundeni lehtë dhe sigurtë të regjistroni dhe transferoni pasurinë tuaj. Me standarde gjithashtu bëhet përmbledhja e veprimeve që duhet të ndërmarrin gjykatat, drejtorati për çështje pronësore banesore, autoritetet komunale dhe policia duhet të ndërmarrin hapa për të luftuar okupimet ilegale, kultivimin, dhe ndërtimet në pronë, si dhe aksionet që autoritetet komunale mund të ndërmarrin në mbrotje të të drejtave pronësore të atyre që jetojnë në vendbanime joformale.

Me qëllim të përmirësimit të mbrojtjes së të drejtës pronësore, qeveria qëndrore dhe komunale duhet të punojnë së bashku. Për këtë arësyet mandati i standardit të të drejtës pronësore/trashëgimisë kulturore si një aksion i



parë i themelimit të një grupi të ekspertëve për çështjen pronësore në mënyrë që të bashkojë të gjitha agjencionet që të punojnë për çështjet pronësore që ka të bëjë çdo ditë me ju. Ky grup ende nuk është takuar deri më sot. Misioni i OSBE-së fton Institucionet e Përkohshme Vet-Queverisëse (IVPQ) që të vepronin pa vonesë.

Mirëpo përmbushja e standardit për të drejtat pronësore nuk është një çështje që i përket vetëm qeverisë. Kjo ju takon edhe juve – si posedues të pronës. Ne duhet të përmbahemi nga okupimet ilegale, shfrytëzimit, kultivimit apo blerjes së pronave. Ne duhet të ju tregojmë të tjerëve të respektojnë të drejtën pronësore; dhe të marrin pjesë në procesin e planifikimit hapësinor për të siguruar mbrojtjen e të drejtave tona.

*Sven Lindholm, zëdhënës
i Misionit të OSBE-së*

“Redaktorët e Detaje-ve dëshirojnë të kërkojnë falje për një fotografi mashtruese të publikuar në edicionin tonë të prillit. Fotografia paraqiste një fëmijë me flamur shqiptar para një shtëpie të djegur, ku teksti i shkruar nën të e paraqiste si shtëpi të sebëve. Mirëpo, më vonë kemi mësuar se shtëpia i takonte familjes shqiptare të fëmijës. Shtëpia ishte pran disa shtëpive serbe që gjithashtu ishin djegur. Familja ka sqaruar se ka vënë flamurin shqiptar në shtëpi me shpresë që ta ruaj nga shkatërimi i mëtutjeshëm. Ne na vjen keq për gabimin e lëshuar.”

DETAJE

Gazetë e publikuar nga OSBE-ja

OSCE HQ, 38000 Prishtinë / Pristina Tel (+381-38) 500 162

Fax: (+381-38) 500 188

E-mail: osce-kosovo@omik.org

Web site: www.osce.org/kosovo

Botuesi:

Sven Lindholm

Kryeredaktorë:

Arni Snaevarr

Redaktorë:

Hasan Sopa (Detaje), Slavisa Mladenović (Detalji)

Faqesja:

Albert Shala

Vizatimet:

Shpend Kada

Bashkëpunorët:

Jose Maria Arraiza, Kresnik Basha, Edita Buçaj, Marc Kalmbach, Fatime Lepaja, Rexhep Krasniqi Zenuh Pajaziti, Halide Sadiku, Mevlode Salihu, Ardiana Sejdiu, Hjortur Sverrisson & Bernard Vrbani

osce


Mission in Kosovo

Shënim:

Pikëpamjet e paraqitura apo prezantimi i materialeve të botuara nuk shprehin politiken, opinionet apo qëndrimet e misionit të OSBE-së në Kosovë.

Pronarët pa shtëpi

12,000 raste të okupimit ilegal ende të pazgjidhura



“Nuk mund të shkosh as për të parë vendin ku ke lindur e je rritur”, thotë Bekim Maxhuni
Fotografia Hasan Sopa



“Nuk është e lehtë të qëndrosh para shtëpisë dhe ti shikosh njerëzit që nuk i njeh në shtëpinë tuaj”, thotë Nebojsa Kostiq/Fotografia Hasan Sopa

Nga Arni Snaevarr, OSBE

Gjatë pesë viteve të fundit janë regjistruar rreth 29,000 ankesa për okupim ilegal të pronës në Drejtoratin për Çështje të Banimimit në Kosovë, prej të cilave gati 60% janë zgjidhur me sukses. Megjithatë, rreth 12,000 raste kanë mbetur të pazgjidhura, që do të thotë se dhjetë nga një mijë njerëz në Kosovë nuk kanë qasje në pronën e tyre. Ata janë pronarë pa shtëpi.

Nga 29,000 ankesa më shumë se një mijë raste janë të periudhës së mëherëshme të vitit 1989-1999 kur prona shitej dhe blehej, megjithëse ka qenë e mundur që shitblerjet të mos jenë regjistruar. Por më shumë se 27,000 janë bërë për shkak të konfliktit gjatë viteve 1998-1999. Meqenëse Habitatat nuk ka mbledhur statistika mbi shkatërrimin etnik të pronës, siç duket është e qartë se shumica e rasteve më të reja involvojnë pronat e serbëve dhe të romëve të Kosovës. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se është vetëm “çështje e minoritetit” në Kosovë, por është një çështje që prekë të gjitha grupet etnike. Dhe të gjithë këta njerëz pësojnë njësoj.

Të tjerët në apartamentin tuaj

“Është shumë vështirë të qëndrosh jashtë shtëpisë tuaj duke shiquar njerëzit që nuk i njeh në apartamentin tënd,” thotë Nebojsa Kostiq, inxhinier i tregtisë. Ai ende nuk ishte kauluar në apartamentin e tij të ri në Dardani, kur u largua nga Prishtina në vitin 1999. Apartamenti ishte ndërtaur nga kompania për ndërtime publike për të cilën ai kishte punuar, 95% kishte qenë i përfunduar, parketi dhe pajisjet e banjës ishin jashtë ndërtesës në pritje për instalim.”

Menjëherë pas kthimit të tij në Kosovë në fund të dhjetorit të vitit 1999 me përcjellje të KFOR-it deshti ta kthejë apartamentin e tij. Ai bisedoi me familjen që e kishin usurpuar banesën, duke qëndruar para derës, kërkoi prej tyre ose të lirojnë banesën ose ta blejnë atë. Ata i prematuan se do t'i lajmrohen por nuk e bënë këtë. “Kisha dashur të kthehem por më nuk mundem të sigurojë përcjelljen e KFOR-it.” spjegon Kostiqi.

Shumë njerëz në Kosovë e njohin Bekim Maxhunin si basketbollist profesionist, por

të paktë janë ata që e dijnë se edhe Bekimi, si shumë të tjerëve në Kosovë, i mohohet e drejtat elementare, ajo e pronës. “Po, për fat të keq unë kam banesën në pjesën veriore të Mitrovicës” thotë Bekimi. “Kam poashtu edhe një truall që ka pasur të njëjtin fat. Unë e di kush është i vendosur në banesën time por çka ka efekt kjo?”

Bekimi thotë se ka shkuar në Habitat dhe ka lajmëruar rastin. “Nuk më është përgjigjur njeri deri tani, pra askush nuk ka treguar interesim për këtë çështje.”

S`mund ta vizitosh vendlindjen

Sidoqoftë, për ata të cilëve në mënyrë ilegale iu ka okupuar apartamenti apo ata që kanë okupuar pronë ky nuk është vetëm ndonjë problem ekonomik si tërësi për shoqërinë ose ndonjë ngarkesë financiare, por është një ngarkesë emocinale. “Kam kulm mbi kokë, por nuk kam. E të mos flas për atë se si ndjehesh kur nuk mund të shkosh as për të parë vendin ku ke lindur e je rritur. Se di sa mund ta kuptoni këtë.”

Në pyetjen se si ndihet, Nebojsa thotë: “Më e rëndësishme ishte të mbijetoje gjatë konfliktit se sa të mendoje për banesën”. Për fat të keq nuk është e çuditshme të jesh viktimë e dhunës etnike, pasi që gjatë trazirave të marsit ai është dashur që të largohej nga apartamenti i tij në ndërtesën e YU programit, në lagjen Ulpiana në Prishtinë.

“Problemi më i madh është se papritmas i ke humbur të gjitha” shpjegon Bekimi. “Më nuk ke qasje në pronën për të cilën ke dëshmi ligjore e valide se të takon” Pastaj nuk mendohet në aspektin afatgjatë. Kush do ta vlerësojë dëmin që më është bërë gjatë kësaj kohë, apo të paguajë për atë. Çfarë ndodh me faturat e mbledhura të rrymës, telefonit, shërbimeve publike? S`ma merr mendja që ato paguhen.”

Nebojsa ende nuk i ka humbur shpresat për kthimin e apartamentit të tij. “Nuk heq dorë.” Megjithatë, ai nuk është shumë optimist se do të gjindet një zgjidhje, edhe Bekimi mendon njësoj: “Pritja po zgjatë, shpresat po humbin.”

Errësira buzë qytetit: Mahalla e romëve

Nga Jose Maria Arraiza, OSBE

Në esencë ka pak ndryshime. Pesë vite pas plaçkitjes dhe djegjes së lagjes së romëve në Mitrovicë, mahalla e romëve vetëm disa metra larg urës kryesore, qëndron si një qytet lugatësh. Po ta vështrosh këtë lagje nga ana veriore e lumit Ibër, do të keshë pamjen e skeleteve të shtëpive që shtrihen në një parregullësi të plotë. Muret janë shkatërruar duke iu hequr tjegullat një nga një. Në grumbullin e baltës dhe rrënojave është rritur shumë barë dhe zogjët kërkojnë diçka për të ngrënë, aty ku dikur në rrugët e vendbanimit joformal më të madhë të romëve, kishte plot gjallëri.

Kjo pamje e zbehtë, e fshehur nga rrugët kryesore të Mitrovicës dhe në përgjithësi nga vëmendja e mediave vendore dhe ndërkombëtare, është vështirë të kuptojnë se si ishte jeta e qindra familjeve që jetonin aty. Sigurisht se duhet të ketë qenë një lagje mjaftë e gjallë. Dhe me sa duket marrëdhënjet mes fqinjëve nuk kanë qenë të dobëta.

Gjatë vizitës së fundit “Shko, shiqo dhe vizito”, të cilën e organizoi UNCHR-ja dhe Këshilli Danez për Refugjatë (DRC), një grup i të moshuarëve të zhvendosur nga kjo lagje ishin mirëpritur ngrohtësisht nga zyrtarët komunal. “A do të ketë vëllazëri në mes të komuniteteve tona nëse kthehemi?” pyeti një rom i vjetër nënkryetarin e kuvendit komunal. Bile, edhe më të drejtpërdrejt: “A do të ketë punë për neve, mjekë, shkolla për fëmijët tanë, a do të jemi të sigurtë?”

Këto pyetje ia shtuan peshën kokëdhimbjes tashmë të madhe për të bërë klasifikimin se ku dhe kush është pronar i vendeve ku shtëpitë ishin shitur dhe jozyrtarisht ishin trashëguar me dekada, ku toka publike ishte okupuar dhe asnjë plan urban nuk ishte përpiluar ndonjëherë.

Varfëria e personave të zhvendosur

Përderisa DRC-ja dhe komuna ende mendojnë për mahallën, kushtet momentale të jetesës së personave të zhvendosur nuk janë fare të mira. Nëse i vizitoni kampet e personave të zhvendosur në Zhitkoc (Zvečan), Cesmin Lug (Mitrovicë) ose Leposaviq është sikur ke hyrë në një botë tjetër, jo vetëm në një shtrirje të ndryshme kuturore, por në një hapësirë me varfëri të madhe. Qindra familje që jetojnë në baraka kanë kushte të mjerueshme. Hapësira është e kufizuar, ajrosja e dobët, dhe qasja për punësim, arsimim dhe shëndetësi është duke u zvogëluar. Ata i pranojnë vizitorët vendor dhe ndërkombëtarë me një pikë dyshimi. UNMIK-u, përfshirë OSBE-në, UNCHR-i, Habitatit dhe një numër i madh i OJQ-ve i kanë vizituar ata gjatë pesë viteve



Errësira buzë qytetit. Kjo pamje e zbehtë e bënë të vështirë të kuptosh se si ishte jeta e qindra familjeve që para lufte jetonin në 'Rrugën e Fabrikës'

Fotografia: Hjortur Sverrisson/OSBE

të fundit për të dëgjuar brengat e tyre dhe kanë diskutuar zgjidhje të ndryshme për problemet e tyre.

Në përgjithësi, akterët e ndryshëm ndërkombëtar kanë pasur vështirësi në dhënie e përgjegjësi dhe mandatet udhëheqësve romë. Romët logjikisht, shpeshëherë presin ndihmë nga institucionet dhe agjencitë të cilat nuk kanë mandat për këtë. Dhe kur nuk u ipet ndihmë ata i humbin shpresat dhe besimin.

Plaçkitja dhe djegia e shtëpive të ashkallive në ngjarjet e fundit e ka keqësuar edhe më tepër situatën. Personat e zhvendosur të cilët vizituan mahallën në këtë qershor ishin shumë të vetëdijshëm se çfarë kishte ndodhur atje.

Marsin e kaluar, ashkalinjtë e Vushtrisë shikonin me habi se si lagja e tyre po digjej për herë të dytë gjatë pesë viteve. Të strehuar në fshatin Novosellë, në kampin e KFOR-it francez, ata kërkuar azil në vendet perëndimore si një opcioni i vetëm i mundshëm për të ndëratur jetën e tyre përsëri. Ata madje bënë edhe grevë urie për të theksuar kërkesat e tyre. Edhe pse nuk fituan azil, për fat të mirë greva e urisë mbaroi.

E drejta për banim të përshtatshëm

Është vështirë për qeverinë dhe komunitetin ndërkombëtarë që të fitojnë besimin e banorëve romë, ashkalinjë dhe egjiptian. Por, iniciativa për promovimin dhe

mbrojtjen e të drejtave të tyre vazhdon.

Vitin e kaluar, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Bosnë dhe Hercegovinë, ka organizuar një tryezë të rrumbullakët rajonale për formalizimin e vendbanimeve joformale të romëve dhe grupeve tjera të rrezikuara (shiqo: “formalizimi i vendbanimeve joformale do të përmirësojë të drejtat e njeriut”, faqe 7.) Përfaqësuesit e romëve, OJQ-të, donatorët, qeveritë, dhe organizatat qeveritare diskutojnë në mënyra të ndryshme për të mbrojtur të drejtën për strehim adekuat dhe formalizimin e gjendjes së familjeve që jetojnë në këto lagje të varfëra.

Qasja kryesore ishte të konsiderohen banorët e mahallës si persona me ‘të drejtë të njëjtë ndaj qytetit’ si të gjithë të tjerët. Me pak fjalë, qasja e barabartë në shërbime dhe punësim, përfaqësimi politik dhe e drejta formale ndaj pronës. Rezultatet ishin kumtuar në qershor nga kryeministri i Kosovës dhe nga OSBE-ja. Komiteti drejtues është formuar në nivelin qëndror për të analizuar në detaje situatën dhe përgatisë planin e punës për tërë Kosovën për të adresuar problemet e qetetarëve e edhe banorëve të mëparshëm të vendeve siç është mahalla e romëve e të tjera.

Disa gjëra po ndryshojnë. Ndërkohë, rrënojat e mahallës së romëve shtrihen qetë pranë lumit në pritje për dokumentacionin dhe përmblidhjen e premtimeve nga ata që janë në pushtet se ndoshta një ditë do t’ia kthejnë jetën lagjes.

Zyrtarizimi i vendbanimeve joformale

OSBE-ja dhe kryeministri i Kosovës prezantuan rezultatet e një tryeze të rrumbullakët

Nga Mevlyde Salihu, OSBE



"Ne angazhohemi për shqyrtimin e mundësive që aty ku është e mundur, të formalizohen, gjegjësisht zyrtarizohen këto vendbanime," kryeministri Bajram Rexhepi.

Fotografia Hasan Sopa

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi, prezantuan dokumentin përfundimtar të nxjerrë nga një tryezë e rrumbullakët rajonale mbi vendbanimet joformale të romëve dhe grupeve tjera të rrezikuara.

Ky dokument është rezultat i "Tryezës së Rrumbullakët Rajonale mbi Zyrtarizimin e Vendbanimeve Joformale për Romët dhe Grupet tjera të Rrezikuara," i cili është prezantuar nga shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, ambasadori Paskal Fieski dhe kryeministri Bajram Rexhepi me 15 qershor të vitit 2004 në Prishtinë.

Të drejtat e njeriut për ata që nuk janë plotësisht pjesë e shoqërisë

Problemet më akute me të cilat ballafaqohen banorët e vendbanimeve joformale janë siguria joformale dhe e pasigurtë e mbajtjes së pronës, qasja joadekuate dhe privimi nga shërbimet elementare, pjesëmarrja joadekuate dhe privimi nga pjesëmarrja në qeverisje dhe cënueshmëria nga diskriminimi. Zyrtarizimi i vendbanimeve joformale është shumë i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të këtyre banorëve.

"Ne dëshirojmë të mbrojmë të drejtat e të gjithë popujve në një shoqëri, në mënyrë

që të jenë të sigurtë dhe të kenë mundësi të jetojnë në prosperitet," tha ambasador Fieski. Ai shtoi se "zyrtarizimi i vendbanimeve joformale do të ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të dëmtuara në shoqëri, por poashtu do të ndihmojë edhe në zhvillimin ekonomik të rajonit."

Dokumenti përmban tetë konkluzione të përgjithshme, dhe vë në pah se qeveritë qendrore dhe lokale kanë për detyrë, në bazë të së drejtës ndërkombëtare, veçanërisht pjesës që ka të bëjë me të drejtën për banim adekuat, të përmirësojnë gjendjen e banorëve në vendbanime joformale.

Ky dokument ndihmon krijimin e një politike për qeveritë rajonale për të përmirësuar pozitën e banorëve të vendbanimeve joformale. Aktualisht, ata nuk gëzojnë të drejtën e plotë për strehim adekuat dhe pronë, nuk kanë gjithmonë qasje të barabartë në shërbime apo pjesëmarrje në qeveri. Ata shpesh jetojnë në shtëpi të improvizuara, në rajone ku nuk ka rrugë të përshtatshme, burime të besueshme të rrymës, ujë të pastër dhe sanitari.

"Duke pasur për bazë rëndësinë e vendbanimeve joformale për ekzistencën e komuniteteve etnike dhe racore, ne angazhohemi për shqyrtimin e mundësive që aty ku është e mundur, të formalizohen, gjegjësisht zyrtarizohen këto vendbanime," tha kryeministri Rexhepi.

Përmirësimi i jetës për disa i ndihmon të gjithë

Vendbanimet joformale janë vendbanime njerëzore të cilat nuk i mundësojnë banorëve të tyre të ushtrojnë të drejtën e tyre themelore për standard adekuat të jetesës, veçanërisht të drejtën për banim adekuat. Njerëzit që jetojnë në vendbanime joformale – posaqërisht ata që u përkasin grupeve të rrezikuara, përfshirë këtu romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit – janë të marginalizuar nga komuniteti shumicë. Ata shpeshherë bëhen objekt i shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe nuk u ipet mundësia për pjesëmarrje të plotë në qeverisje.

Në veçanti, banorët e vendbanimeve joformale nuk gëzojnë të drejta për qasje në pronë dhe për shfrytëzim të saj, duke iu ofruar mbrojtje nga shkeljet e të drejtave të njeriut siç janë dëbimet me dhunë dhe që ekzekutohen pa vendim gjyqësor.

Përmirësimi i standardit të jetesës dhe infrastrukturës për të gjithë banorët e Kosovës në përgjithësi, dhe atyre që jetojnë në vendbanimet joformale në veçanti, do ta bëjë Kosovën vend më të mirë për të jetuar. Siç tha edhe kryeministri Rexhepi, "Kosova demokratike do të ketë perspektivë të mirë vetëm atëherë kur të gjithë qytetarëve të saj do tu garanton liri, të drejta dhe mundësi të barabarta."



Rrënojat e mahallës së romëve shtrihen qetë pranë lumit në pritje të dokumentacionit dhe përmirësimit të kushteve nga ana e pushtetarëve, se ndoshta një ditë do t'ia kthejnë jetën lagjes.

Fotografia Hjortur Sverrisson/OSBE

Përvoja e Bosnës dhe Hercegovinës: model për Kosovën

Nga Bernard Vrbani, OSBE

Pas luftës në Bosnë dhe Hercegovinë, respektimi i të drejtës pronësore ishte i rëndësishëm për vendin për tu pranuar ndërkombëtarisht. Integrimi i mëtejshëm në strukturat Evropiane dhe botërore varej nga shkalla e lartë e promovimit të vazhdueshëm të vendit dhe përparimit të çështjeve siç është e drejta pronësore. Kështu pra rruga ishte e vështirë, institucionet vendore dhe opinioni i gjërë publik kishin arritur të kuptojnë se duke respektuar të drejtën pronësore, ata përmirësojnë standardin e tyre të jetesës.

Kosovo nuk mund të presë përmirësim të standardit të jetesës, dhe sigurisht as integrimin në Evropë, pa arritur konkluzionet e njëjta sikur fqinjët e sajë në perëndim. Standardet kanë qenë të imponuara, janë pranuar dhe kanë funksionuar në vende tjera – ato duhet të pranohen dhe të funksionojnë edhe këtu.

Përvoja e Bosnës dhe Hercegovinës për Kosovën është udhërrëfyese sipas intervistës që Detaje e bëri me Elmira Bajrasli, zëdhënëse e Misionit të OSBE-së në Bosnë dhe Hercegovinë.

Zbatimi i ligjit në mënyrë të përpikt

Detajet: Kosova duhet të përmbushë standardet para diskutimeve për statusin final. Në këto standarde është përfshirë edhe çështja e të drejtës pronësore. Përveç faktit se në Bosnë dhe Hercegovinë, çështja e të drejtës pronësore nuk është trajtuar si "Standard", a kishte kërkesa të caktuara që duhej të plotësoheshin?

Në Bosnë dhe Hercegovinë, është një numër i standardeve përkundrejt të cilave matet progresi drejt një shoqërie të hapur, demokratike dhe ndërtuar në baza të respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Standardet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe të drejtën pronësore, në mënyrë të veçantë, janë vendosur në shtojcën e marrëveshjes së Dejtonit për paqë. Parimet, kompetencat dhe institucionet të parashtrura në shtojcën 6 dhe 7 të Dejtonit ishin absolutisht themelore për implementimin e ligjeve pronësore.

Mbrenda kornizës njerëzitet kishin një grup gjithëpërfshirës të të drejtave dhe zgjidhjeve që të parashtrorin kërkesat e tyre për të riposeduar pronësinë e tyre, në këtë mënyrë të lejohet kthimi, nëse ata dëshirojnë këtë.



Përfaqësuesit të Lartë i është dhënë autoritet i plotëfuqishëm për largimin e zyrtarëve të padëgjueshëm. Lordi Ashdoun, me Robert Meison Bikroft, shefi i misionit të OSBE-së në Bosnë dhe Hercegovinë.

Fotografia: OSBE

Procesi i implementimit të ligjit për pronën nuk ishte pa probleme.

Komuniteti ndërkombëtarë ka themeluar Planin për Implementimin e Ligjit për Pronësinë (PLIP) dhe njësinë e PLIP-ës, të përbërë nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë (OHR) (i ngajshëm me UNMIK-un në Bosnë dhe Hercegovinë, ndonëse edhe me autoritet me ndikim më të gjërë) dhe organizata tjera ndërkombëtare, duke përfshirë këtu edhe OSBE-në.

Standardet të cilat duhej të përkrahen nga autoritetet vendore ishin të qarta. Kur dhe ku autoritetet vendore kishin dështuar të pajtohen, Përfaqësuesi i lartë i shkarkonte zyrtarët vendor që pengonin ose u hiqte atyre të drejtën për pjesmarrje në zgjedhje. Edhe qytetarët ishin të obliguar që të përkrahin standardet. Ata duhej të lironin pronat që i kishin zënë në mënyrë ilegale mbrenda afatit të caktuar ose duhej të dëboheshin. Një Qasje e sundimit të ligjit në mënyrë të përpikt ishte pranuar nga komuniteti ndërkombëtarë për të zgjidhur situatën e pronësisë dhe ishte bërë kjo përmes zbatimit të rreptë të standardeve, që Bosna dhe Hercegovina gati kishte arritur të përmbush plotësisht riposedimin e pronës në mbarë vendin.

Rezultatet më të mira ishin aty ku vendorët kanë pranuar regjimin e riposedimit të pronës

Detajet: Lidhur me çështjen e të drejtës pronësore, në çfarë forme ishte bërë bashkëpunimi mes autoriteteve vendore dhe komunitetit ndërkombëtarë?

Republika Serbe dhe Federata e Bosnës dhe Hercegovinës kanë parlamente dhe qeveri të ndara, ndërsa disa detyra siç është mbrojtja është rezervuar për qeverinë qendrore. Në këtë fushë parlamentet e etniteteve përkatëse fillimisht kanë miratuar ligjet për pronën, ndërkohë që edhe përfaqësuesi i lartë ka imponuar amendamentet, në konsultim me njësinë e PLIP-it, që të plotësoj boshllëkun në ligje dhe përforcojë mbështetjen për njerëzit që kërkojnë pronën e tyre.

Organet administrative vendore janë përgjegjëse për implementimin e këtyre ligjeve. Pika kontaktit janë caktuar nga komuniteti ndërkombëtar në secilën komunë për monitorim të zbatimit të ligjit dhe të raportojë për problemet eventuale. Kurdo që paraqitëshin kundërshtime lidhur me interpretimin e ligjeve apo mod-eleve, njësia e PLIP-it nxirrte udhëzime

E drejta pronësore

autoritative ose për pikat e kontaktit ose drejtpërdrejt për ministrinë kompetente. Mbledhja dhe analizimi sistematik i statistikave që kishin të bënin me implementim, ishin gjithashtu element i domosdoshëm për eliminimin e problemeve dhe identifikimin e fushave të progresit në implementimin e ligjit.

Implementimi i ligjit në pronësi u bë më së miri aty ku partnerët vendor kishin zbatuar regjimin e riposedimit të pronës dhe kishin punuar me partnerët ndërkombëtar për të siguruar se ishin zbatuar rregullat.

Dëbimi i uzurpatorëve të përkohshëm

Detajet: *Çfarë ishte plani për implementimin e ligjit të pronësisë (PLIP)? Kush e krijoi atë dhe pse? Kush e siguroi zbatimin?*

PLIP-i ishte rezultat i nevojës për të koordinuar përpjekjet e organizatave të ndryshme për implementimin e ligjeve pronësore në teren. Disa organizatave iu ka dhënë kompetenca në lidhje me aspektet e ndryshme të ligjeve për pronën nga marrëveshja e Dejtonit për paqë. Zyrës për të drejta të njeriut i është dhënë përgjegjësi për mbikëqyrje të procesit, OSBE-ja ishte involvuar ngushtë me monitorimin e implementimit në teren. UNCHR-ja ishte përgjegjëse për mbrojtjen dhe asistimin e njerëzve që ktheheshin në shtëpitë e tyre dhe CPRC kishte një rol në gjykimin e kërkesave për pronësinë.

Pjesa më e rëndësishme e implementimit të ligjit për pronën, që dikujt i duket e pazakonshme, ishte insistimi absolut se okupuesit e përkohshëm të dëbohen sapo kërkesa të bëhet e vlefshme për shtëpinë apo apartamentin e okupuar. Në fillim ata i rezistuan kësaj me të madhe, për shkak se me mijëra njerëz do të mbeteshin pa shtëpi. Mirëpo, për secilin që vërtetë nuk kishte zgjidhje të përshtatshme banim, i është siguruar strehim alternativ. Në fund, njerëzit nuk kanë mbetur në rrugë, nuk pati bllokim kritik në sistem, nevoja për të larguar një familje, në mënyrë që të kthehet pronari i paraluftës u tejkalua.

Rritja e efikasitetit të procesit të implementimit, për të siguruar se të drejtat pronësore individuale, varën nga akterët e lartë përmendur që punojnë në marrëveshje. Duhet të përmendim se, domosdoshmëria e krijimit të PLIP-it doli nga fakti se, njerëzit në mënyrë masive kërkonin pronën e tyre. Realiteti i mijëra njerëzve të cilët kishin ushtruar të drejtat e tyre në sistemin e ligjeve, institucioneve, shoqërisë civile dhe asistencës ndërkombëtare dhe mbikëqyrja në lëvizje, përfundimisht ishte një sistem i cili siguroi zbatim

për standardet, më tepër se ndonjë akterë tjetër.

Përparimi

Detajet: *Sa kohë iu është dashur autoriteteve përgjegjëse të kuptojnë obligimet e tyre sipas PLIP-it?*

Fillimisht kishte më shumë rezistencë për implementimin e ligjeve të pronësisë, sa që nganjëherë problemi dukej plotësisht i pazgjidhshëm. Mirëpo, një përparim i rëndësishëm ishte që okupuesit ilegal dhe zyrtarët vendor kuptuan se situata e tillë nuk mund të vazhdonte. Ishte momenti kur njerëzit kuptuan se dëmi i bërë gjatë luftës duhej të rregullohej dhe kjo do të ndikonte në përmirësimin e marrëdhënjëve deri në një shkallë. Përparimi i dytë ndodhi në shtator të vitit 2002 kur njësia e PLIP-së nxorri direktivën e re strategjike, e cila i përmboldhi parimet e Dejtonit dhe ligjet për pronën, duke theksuar të drejtën për kthim, përpunimi kronologjik i kërkesave dhe nevojave për implementimin e vendimeve për dëbim, në këtë mënyrë i mohon autoritetit vendor lirinë e veprimit mbi rendin e përpunimit të rastit. Direktiva e re strategjike krijoi siguri ligjore, drejtësi dhe transparencë për të dy paditësit dhe okupuesit e përkohshëm dhe i dha shtytje të re implementimit të

ligjit për pronën.

Detajet: *A e pranoi masa e gjërë rëndësinë e të 'Të drejtës Pronësore'; p.sh. okupimet ilegale? Si plasohet porosia deri te opinioni publik?*

Shumica dërmuese e njerëzve nuk kanë dëshirë që të vjedhin apo të okupojnë shtëpitë e të tjerëve. Vjenë momenti kur njerëzit thonë, 'dosta je' – 'mjaft' – dhe fillojnë të gjejnë mënyra për zgjidhjen e situatës.

Detajet: *Pranimi i PLIP-së a e sjellë Bosnën dhe Hercegovinën një hap më afër Evropës, në mendjen e vendorëve dhe ndërkombëtarëve?*

Bosna dhe Hercegovina kanë bërë zotimin para Këshillit të Evropës për implementimin e ligjeve pronësore. Progresi i bërë ka qenë vërtetë i rëndësishëm, më tepër me meritën e autoriteteve vendore, mbi të gjitha të njerëzve të Bosnës dhe Hercegovinës. Disa patën thënë se duhet të kalojnë 40 vite ose edhe më shumë, por ja ku jemi, tetë vite më vonë, në prag të përfundimit të kapitullit të dhimbshëm në historinë e vendit. A është vendi më afër Evropës? Pra, kur flasim për standardet, Bosna dhe Hercegovina ka vendosur parmakët shumë lartë për fqinjët në Evropën jug-lindore dhe, në të vërtetë për tërë Evropën.



Atëherë dhe aty ku autoritetet vendore mohonin të bashkëpunonin, Përfaqësuesii i Lartë i largonte zyrtarët që pengonin apo edhe ua ndalonte atyre pjesëmarrjen në zgjedhje. Sarajeva kryeqyteti i Bosnës dhe Hercegovinës

Fotografia: OSBE

Një dritë në fund të tunelit

Dy burra nga anë të kundërta bashkohen për të mbrojtur një vend me trashëgimi botërore

Nga Arni Snaevarr, OSBE

“Trashëgimia kulturore e Kosovës respektohet si një trashëgimi e të gjitha komuniteteve etnike, religjioze dhe gjuhësore të Kosovës” (Standardet për Kosovën)

Nga dukja e jashtme, ata duken si dy burra të ndryshëm. Në njërën anë është Ibrahim Selmonaj i ulur pranë tavolinës në zyrën e tij si kryetar i kuvendit komunal të Deçanit. Pas tij është shqiptarja e zezë dykrerëshe në një sipërfaqe të kuqe, simbol i nacionalizmit shqiptar. Në anën tjetër, disa kilometra më larg, Atë Sava në mantelin e tij të zi prej një murgu ortodoks, u tregon gazetarëve një xhirim të internetit ku shihet shkatërimi i kishës ortodokse në Podujevë. Por, pamjet mund të jenë mashtruese. Këta dy njerëz kanë një gjë me rëndësi të përbashkët – interesimi dhe roli i tyre vendimtar në ruajtjen e manastirit të Deçanit gjatë trazirave të marsit, njëri prej objekteve kulturore më të rëndësishme të Kosovës i shekullit të XIV.

Luftimi i të kaluarës

Kisha të djegura, xhami të djegura; konfliktet në Kosovë tradicionalisht nuk kanë rezultuar vetëm me humbje në njerëz. Ekstremistët nuk i kanë vënë në shënjestër vetëm jetën e etnive të tjera, por gjithashtu edhe historinë dhe trashëgiminë e tyre kulturore.

Një numër i madh i kishave ortodokse dhe objekteve tjera fetare u dogjën gjatë trazirave të marsit, përfshirë këtu edhe atë që kishte mbetur nga manastiri i arangjelit të shenjtë afër Prizrenit. Shpresojmë që të sanohet dhe të arrijë lavdinë e tij të mëparshme sikurse xhamia e kuqe në Pejë dhe shumë objekte historike në Gjakovë, të djegura gjatë konfliktit të vitit 1999.

Po të mos intervenonin disa njerëz qëllimorë, të njëjtin fat do ta kishte pasur edhe manastiri i Deçanit, monumenti më i mirë historik në Kosovë.

“Të gjitha komunitetet kanë të drejtën e ruajtjes, riparimit dhe mbrojes së objekteve që kanë rëndësi për trashëgiminë e tyre kulturore, historike dhe fetare me ndihmën e autoriteteve relevante (IPVQ) konform standardeve Evropiane.” (Standardet për Kosovën)

Edhe pse ngjarjet e marsit hodhën një hije të zezë mbi Kosovë, ende mund të ketë dritë në fund të tunelit. Është vështirë për një gazetar i cili e viziton manastirin historik të Deçanit, një ditë vere të qetë, më shumë se tre muaj pas ngjarjeve të marsit, të parafytyrojë një turmë të zemëruar duke ecur drejt manastirit me qëllim që ta ndezin atë, i cili



Muajn e kaluar manastiri i Deçanit është futur në listën e UNESCO-s për trashëgimi botërore. “Një sintezë e vçantë e traditës bizante dhe moderne” thuhet në arsyetimin e UNESCO-s.

Fotografia: Hjortur Sverrisson/OSBE

tash së fundi i është shtuar listës ekskluzive të UNESCO-së për trashëgimi botërore.

Në atë moment, z. Ibrahim Selmonaj, kryetar i kuvendit komunal të Deçanit ishte në zyrën e tij disa kilometra larg prej manastirit. Si person që kupton konfliktin, ai nuk pati dyshim se qëllimi i turmës ishte për të djegur manastirin historik dhe se viktima do të kishte nga të gjitha anët, nga shqiptarët, serbët dhe KFOR-i italian, që ishte duke e ruajtur këtë vend historik.

Shpëtimi nga gremina

Gjatë konfliktit të vitit 1999, Deçani ishte një nga bazat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. z. Selmonaj ishte një nga komandantët e UÇK-së në këtë komunë duke shërbyer nën komandën e z. Ramush Haradinaj, një udhëheqës rajonal i UÇK-së dhe tani kryetar i degës së AAK-së. Para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-së në pranverën e vitit 1999, shumica e qytetarëve kishin ikur nga shtëpitë e tyre dhe rreth 65% e shtëpive ishin shkatërruar tërësisht.

Z. Selmonaj e dinte se shumë njerëz ndjenin armiqësi kundër disa serbëve kosovarë që kishin mbetur në këtë komunë. Por, ata gjithashtu ishin të zemëruar dhe frustruar për shkak të lajmit për mbytjen e fëmijëve në lumin Ibër. Ai nuk ishte i vetmi person që ishte i brengosur për situatën e rrezikshme dhe shpërthyes.

Bota e jashtme dhe përfaqësuesit e huaj po vëzhgonin situatën dhe ishin të brengosur për fatin e manastirit. Të gjithë i luteshin që të garantojë sigurinë e manastirit. Z. Selmonaj ishte në kontakt të drejtpërdrejt me manastirin, duke folur mes të tjerëve edhe me Atë Savën.

“Nuk isha i befasuar me intervenimin e kryetarit të kuvendit dhe kolegëve të tij. Unë kisha biseduar me komandantin e NATO-së, admiralin Xhanson”, komenton Atë Sava. “Amerikanët ishin në kontakt me z. Selmonaj dhe kolegët e tij, në mesin e të cilëve ishte edhe z. Haradinaj. Unë do të isha befasuar nëse ai do të kishte vepruar ndryshe”.

Kthimi prapa i turmës nuk ishte detyrë e lehtë. “Ishte një konfrontim fizik”, e pranon z. Selmonaj. Kryetari i kuvendit ishte së bashku me disa ish-ushtarë të UÇK-së, në mesin e të cilëve ishte edhe Abdyll Mushkolaj, udhëheqës i veteraneve të luftës në Deçan. Duke përdorur megafonin, z. Selmonaj ia doli që t’i kthejë prapa protestuesit më të zemëruar. Ai lavdëron z. Mushkolaj kontraverzë (i cili ishte arrestuar më vonë nga KFOR-i për nxitjen e dhunës) dhe Ramush Haradinajn, porositë telefonike të të cilit iu transmetuan demonstruesve.

“Nuk e kemi dashur të djegur as atëhere e as tani...”

“Nuk do të ketë as diskriminim e as trajtim të privilegjuar të pronave të trashëgimisë kulturore të asnjë komuniteti”. (Standardet për Kosovën)

Që të dy, z. Selmonaj dhe Atë Sava pajtohen se manastiri do të ishte shkatërruar po të mos ishte ky intervenim. Z. Selmonaj thekson se manastiri do të ishte djegur në qershor të vitit 1999 nëse ai dhe udhëheqësia e UÇK-së do të donin ta bënin këtë.

“Nuk mendoj se dëmtimi i këtij monumenti atëhere do të ishte në interes të Kosovës, dhe as tani nuk mendoj ashtu”, thotë z. Selmonaj dhe shton se “Deçani pa manastir nuk ka vlerë, por edhe manastiri pa Deçan nuk është asgjë”. Ai shprehu mbështetjen e tij për standardet për trashëgiminë kulturore dhe dëshira e tij është që murgjit e manastirit të integrohen në shoqërinë kosovare.

Atë Sava thotë, pa marrë parasyshë se çfarë do të jetë statusi final i Kosovës, është me rëndësi që të garantohet ardhmëria e manastirit të Deçanit. “është një fakt i pranuar se serbët e kanë ndërtuar manastirin dhe se identiteti i ynë është ruajtur. Unë nuk kam asgjë kundër asaj që ai të jetë pjesë e trashëgimisë kulturore të Kosovës, gjithashtu edhe asaj të ballkanit dhe evropës, siç është në Kosovë,” konkludon ai

Çfarëdo që të jenë nuancat e konkludimeve të tyre, këta njerëz janë të bashkuar në ruajtjen e ardhmërisë së manastirit. Kosova është më e pasur. Por gjithashtu edhe bota.



Lartë: Manastiri i Deçanit ka mundur të pësoj fatin e njëjt si manastiri Arkangeli i shenjtë -Piktura të njohura të Deçanit

*Poshtë nga e djathta: Ibrahim Selmonaj, me ish-PSSP z. Harri Holkerin Selmonaj
Poshtë nga e majta: Atë Sava u shpjegon vizitorëve vlerat e manastirit
Fotografia: UNMIK/OSBE.*



Trashëgiminë kulturore duhet ruajtur

Intervistë me z. Behxhet Brajshori, Ministër për Kulturë, Rini dhe Sport

Nga Arni Snavarr, OSBE

Detajet: Si do t'i implementojë IPVQ-ja standardet për trashëgiminë kulturore?

Z. Brajshori: Që nga fillimi ne i kemi kushtuar vëmendje të madhe trashëgimisë kulturore. Për fat të keq monumentet me trashëgimi kulturore kanë pësuar dëme të konsiderueshëm gjatë konfliktit të fundit në Kosovë. Të gjitha ato që janë dëmtuar ose gradualisht janë shkatërruar duhet të riparohen. Trashëgimia kulturore e Kosovës është një thesar i përbashkë dhe duhet të ruhet pa marrë parasyshë se cilës kulturë apo civilizim i takon. Ne kemi pasur një bashkëpunim shumë të ngushtë me këshillin e evropës në hartimin e ligjit për trashëgimi kulturore, i cili është në fazën përfundimtare. Kisha dashur të nxjerrë në pah gjendjen serioze të monumenteve me trashëgimi kulturore në Kosovë dhe që në këtë moment është e pa mundur për t'i shijuar ato. Për këtë arsye ne kemi nevojë për asistencën e komunitetit ndërkombëtar.

Detajet: si mund t'i bëni shqiptarët e Kosovës që të besojnë se trashëgimia e sërbeve të Kosovës është trashëgimi e përbashkët dhe anasjelltas?

Z. Brajshori: Nëse e shiqojmë historinë, shqiptarët e Kosovës nëpër shekuj janë përkujdesur për monumentet historike, përfshirë edhe ato ortodokse. Pra ata e kanë konsideruar si të domosdoshme ruajtjen e trashëgimisë kulturore madje edhe të religjioneve tjera. Dua të theksojë se shqiptarët kanë marrë pjesë në ndërtimin e këtyre monumenteve, duke rindërtuar dhe ruajtur ato

nëpër shekuj çka dëshmon se ata i kanë i konsideruar ato si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore. Nëse shkoni në Deçan do të zbuloni se popullata vendore gjithmonë ka mbrojtur dhe është përkujdesur për manastirin. Nuk e di se a mund të thoni se popullata tjetër ka vepruar ngjashëm me monumentet islamike. Vendet fetare konsiderohen si pjesë të trashëgimisë së përbashkët kulturore, jo vetëm për Kosovën por edhe për trashëgiminë e përgjithshme evropiane. Duhet të bëhen përpjekje që të gjithë të kanë qasjes në monumente, pa marrë parasyshë se cilit religjion i takojnë. E drejta për të gëzuar të drejtën e trashëgimisë kulturore



nuk duhet t'i mohohet askujt.

Detajet: Si është duke përparuar rindërtimi i monumenteve të dëmtuara gjatë trazirave të marsit?

Z. Brajshori: Në ditët e para pas trazirave, ekspertët nga këshilli i evropës dhe UNESCO kanë bërë vlerësimin e dëmeve. Është formuar një grup i ekspertëve, duke përfshirë dy përfaqësues të emëruar nga ministria për kulturës dhe komuniteti sërb me kryetar nga përfaqësuesi i këshillit të evropës. Siç e dini për rindërtimin e objekteve të dëmtuara gjatë trazirave të marsit janë ndarë 3.7 milion Euro nga burimet e limituara të buxhetit të konsoliduar të Kosovës. Tani ne jemi duke bërë vlerësimin e nevojave dhe shpresojmë se disa riparime mund të fillojnë këtë vit. Lista e objekteve që kanë nevojë për intervenim është duke u përgatitur sipas vlerësimeve të Këshillit të Evropës dhe pastaj mund të bëhet një vlerësim i përgjithshëm i dëmeve. Është e qartë se shpenzimet mund të tejkalojnë mundësitë e buxhetit të Kosovës. Ne i lutemi komunitetin ndërkombëtar të na mbështesë në rindërtimin e monumenteve. Ne mund të bëjmë hapat e parë por kemi nevojë për ndihmë urgjente. Shpresojmë se apeli ynë do të dëgjohet.

"Trashëgimia kulturore e Kosovës është e vlefshme dhe duhet të ruhet pamarrë parasyshë se cilës kulturë apo civilizim i takon" thotë Behxhet Brajshori, ministër për kulturë, rini dhe sport në IPVQ.

Fushata e Prizrenit

Nga Kreshnik Basha, OSBE

Më 26 mars, njëzet e një OJQ nga Prizreni filluan fushatën me qëllim të parandalimit të përsëritjes së ngjarjeve të marsit. Fushata në vazhdim e sipër e quajtur "Kosova është shtëpia jonë" është përgjegjia e shoqërisë civile në Prizren për ngjarjet e dhunshme që ndodhën në mesin e muajit mars dhe që rezultoi me humbje në njerëz, humbje materiale dhe dëmtoi imazhin e Kosovës në botë.

"Shpresojmë se kjo fushatë do të shëndërrohet në një lëvizje të strukturuar që do të punojë për një të ardhme më të mirë të të rinjëve pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike," tha z. Bari Zenalaj përfaqësuesi i Qendrës së Komitetit Ndërkombëtar për Shpëtim (IRC) në Prizren.

Kjo iniciativë e mirëfilltë locale, gjeti përkrahje të fortë nga ana e departamentit të Rinisë të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Z. Skender Boshtrakaj, përfaqësuesi i departamentit lavdëroi këtë iniciativë duke theksuar "nevojën për demistifikim të standardeve nga e cila e tërë Kosova do të përfitojë."

Z. Ismet Kryeziu, përfaqësuesi i Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) për Prizren theksoi se "ngjarjet më 17 dhe 18 Mars i vënë në rrezik të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë dhe dhuna ndaj Kosovës është dhuna ndaj familjeve tona".



Si pjesë e kësaj fushate më 29 maj u organizua konferenca e shoqërisë civile e quajtur "Angazhimi i rinisë për shoqërinë demokratike". Përfaqësuesit e gati 70 OJQ-ve nga qytetet e ndryshme të Kosovës vënë në pah shumë çështje vendimtare me të cilat po ballafaqohet rinia e Kosovës. Ata unanimisht theksuan se vetëm me punë të përbashkët problemet ekzistuese mund të zgjidhen.

Rekomandimet kryesore nga konferenca u përqëndruan në parandalimin e përsëritjes së dhunës etnike. Grupet punuese të themeluara ishin: grupi për reformat në sistemin e arsimit, grupi për luftë kundër papunësisë së të rinjëve, grupi për themelimin e qendrave rinore, grupi për përfshirjen e rinisë në krijimin e politikave publike dhe grupi për shtimin e programeve të dedikuara rinisë në radiot dhe televizionet lokale.

Hapi i ardhshëm në fushatën vazhduese do të jetë organizimi i konferencës rajonale për të rinjtë me temën "Çfarë Kosove i duhet rajonit?" me pjesëmarrjen e organizatave rinore nga i tërë ballkani. Qëllimi kryesor i kësaj konference rajonale do të jetë promovimi i tolerances, mirëkuptimit dhe paqës.

Më pranë njerëzve të rëndomtë

Përfaqësuesit e kuvendit komunal në Ferizaj zbulojnë realitetin e hidhur të njerëzve të rëndomtë

Nga Marc Kalmbach, OSBE

Parathënia e standardit të parë të Plnait të Implementimit të Standardeve për Kosovën thotë se; interesat dhe nevojat e të gjithë komuniteteve në Kosovë janë paraqitur plotësisht dhe qartë në të gjitha degët dhe institucionet e Qeverisë si dhe IPVQ siguron shërbime për të gjithë banorët e Kosovës anemban territorit të Kosovës

Si pjesë e këtij procesi të vazhdueshëm, zyra e OSBE-së në Shtërpcë, më 24 qershor organizoi një vizitë tereni për përfaqësuesit e komunës së Ferizajt. Përfaqësuesit e kuvendit komunal, zyrtarë të UNMIK-ut, dhe mediat lokale vizituan fshatërat Dubravë dhe Bablak me qëllim që të nihen më drejtpërdrejt me kushtet e jetesës dhe tu ofrojnë mundësinë qytetarëve të shprehin brengat e tyre para udhëheqësis lokale.

Vendndalimi i parë gjatë vizitës ishte një takim publik në shkollën e Bablakut. Për shkak të kohës së mirë, shumica e fashatarëve ishin të zënë me punë dhe vetëm një numër i vogël i tyre mori pjesë në diskutim. Përfaqësuesit e OJQ-së 'Komiteti i Bashkuar i Metodistëve për Ndihmë' (UMCOR), i njoftuan zyrtarët komunal lidhur me statusin aktual të aktiviteteve të ridërtimit për serbët e kthyer të Kosovës dhe për fqinjët e tyre shqiptarë. Përfaqësuesi i UMCOR-it i shprehu mirënjohje komunës së Ferizajt për përkushtimin dhe angazhimin e tyre në projektin për rehabilitim të komunitetit. Edhe pse qytetarët ngritën shumë brenga, udhëheqësit e Bablakut theksuan rolin pozitiv dhe përkrahës të KFOR-it dhe punën vullnetare të TMK-së. Ai gjithashtu

falënderoi qeverinë e Kosovës për financimin e projektit.

Të gjithë pjesëmarrësit e përkrahën ndjenjën optimiste të udhëheqëve të fshatit dhe e theksuan natyrën simbolike të vizitës si shenjë pozitive që serbët e zhvendosur të Kosovës të kthhen në komunë. Përfaqësuesi i UN-it, për komunën e Ferizajt, z. Dharam Pal, e vlerësoi lartë ndjenjën pozitive të shumë pjesëmarrësve përfshirë edhe znj. Mira Petroviq, një antare e kuvendit komunal, se Bablaku duhet të shërbejë si model për Kosovën.

Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, ishte shumë e qartë se ende ishin kohë të vështira para qytetarëve të Bablakut pasi që situatë ekonomike është shumë e rëndë, si p.sh sistemi i ujërave të zeza dhe ai ujit të pijshëm kanë nevojë për investime të mëdha.

Pjesa e dytë e takimit në Ferizaj solli udhëheqësinë komunale në pjesën e epërme të Dubravës ku jetojnë shumë ashkalinjë të Kosovës. Fshatarët i'u ofruan një pritje të ngrohtë vizitorve dhe i ftuan ata në shtëpitë e tyre.

Ishte më se e qartë se shumë prej anëtarëve të kuvendit komunal dhe nënpunësve të administratës, asnjëherë më parë nuk kishin parë kushte aq të këqija të jetesës. Ishte shokuese për të gjithë kur panë një numër të madh të njerëzve nga foshnjat e posalindura deri të më të vjetrit të

jetojnë në një varfëri dhe mjerim të skajshme. Materiale të thjeshta ndërtimi, nga rrotat e automjeteve të vjetërat deri te kartoni dhe metali i vjetër ishin shfrytëzuara për të ndërtuar shtëpi të improvizuara.

Edhe përkundër kushteve të këqija, banorët e Dubravës nuk hezituan të prezentonin veten dhe shtëpitë e tyre modeste para vizitorëve. Duket se, ata pothuajse ishin të lumtur që ishin në qendër të vëmendjes së publikut, sigurisht për herë të parë në jetën e tyre.

Zyra e lokale e komuniteteve në Sallahanë shërbeu si vendtakim me publikun i cili përcolli vizitën. Një grup prej afërsisht 50 personave pritse me padurim arritjen e z. Adem Salihaj, kryetarit të Komunës së Ferizajt dhe delegacionit të tij. Nganëherë edhe me tone shumë emocionale banorët pjesëmarrës shpalosën hallet e përditshme para politikanëve të tyre.

Ishte inkurajuese të shikosh kur liderët komunal në përfundim të vizitës, veq kishin filluar të diskutojnë për mënyrat se si t'i ndihmonin vendbanimet e vizituara. Z. Salihaj menjëherë kërkoi nga drejtoritë komunale që të hulumtojnë nëse ka në dispozicion ndonjë tokë shoqërore dhe fondacion për një zgjidhje të mundshme banimi. Vetë pranimi institucional i gjendje, si dhe projekti gjithëpërfshirës i komunës së Ferizajt, fillimisht mund të konsiderohet si sukses.



SHPK-ja në rikthimin e besimit

Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) ka hartuar një program qëllim i të cilit është krijimi i besimit në mes të qytetarëve dhe policisë që në moshën e hershme. 'Detajet' mësuhan se këto përpjekje veq kanë filluar të japin rezultate konkrete.

Nga Hasan Sopa, OSBE

Në një shërbim policorë modern, raportet publike janë një element i rëndësishëm në përfitim e mendjes dhe zemrës së njerëzve, dhe si të tilla janë çelësi i suksesit. Në Kosovë padyshim këto janë edhe më të rëndësishme, por ndoshta edhe më të vështira se në shumë vende të tjera, kur kemi parasysh të kaluarën e hidhur të këtij regjioni.

Sektorit i policisë në bashkësi i SHPK-së ka për detyrë thyrjen e barrierave dhe edukimin i publikut për rolin e policisë në një shoqëri demokratike dhe inkurajimin e një bashkëveprimi në mes të SHPK-së dhe qytetarve.

SHPK-ja është themeluar me qëllim të ndërtimit të një baze arsimore mbi të cilën do të ndërtohet shërbimi i policisë në bashkësi. Pra qëllim kryesor ka ndryshimin i botëkuptimeve ekzistuese për policinë me fokus në të rinjë. Programi 'Policët për Fëmijët' është ndër aktivitetet e rëndësishme të SHPK-së në përpjekje të kthimit të besimit në polici. Program i cili vazhdon për katër vite me radhë dhe OSBE-ja ka qenë mjaft aktive në mbështetjen e tij.

Vizita në shkollën e SHPK-së

"Këtu vërtetë qenka bukur, një ambient i pastërt, përplot lule dhe gjelbrim". Ishin fjalët pëshpëritëse të Tahire Rexhës, nxënëse e shkollës fillore 'Bajram Curri' nga fshatit Petrovë komuna e Shtimes. Shikonte rrotull e habitur dhe me siguri për moshën e saj një ambient të bukur si ky po e shihte për herë të parë. Ajo bashkë me një grup prej 70 nxënës të shkollave të ndryshme fillore nga kjo komunë, kishin ardhur për ta vizituar shkollën e SHPK-së në Vushtrri.

Fëmijët po ecnin nëpër oborrin e shkollës së policisë me fytyra të qeshura dhe plot gaz. Jo shumë vite më parë fëmijët tanë nuk kishin guxim të takoheshin ballë për ballë me policinë në rrugë. Vizitat e këtilla kanë për qëllim ndryshimin e një botëkuptimi të tillë.

Gjersa fëmijët po rreshtoheshin për ta filluar vizitën e tyre nëpër ambientin e bukur të kësaj shkolle, ne e pyetëm znj. Tamara Dafin për qëllimin e vizitës së grupeve të ndryshme të nxënësve në shkollën e SHPK-së. "Ata jo vetëm që kanë mundësi të mësojnë për policinë që është në shërbim të komuniteteit të tyre, por gjithashtu kanë rastin të takohen dhe shoqërohen me njëri tjetrin dhe personalisht të bashkëveprojnë me kadetët të SHPK-së" thotë ajo. "Këto përvoja garantojnë bashkëpunimin dhe mardhënjen e besimit të ndërsjellë, të cilat janë garancion për ndërtimin e një shoqëri të shëndoshë".

Programi 'Policët për Fëmijët'

Pas prezantimit dhe historikut të shkurtër të SHPK-ës nga z. Deil Samjuëls, kordinator i sektorit të policisë në bashkësi, fëmijët e filluan vizitën e tyre nëpër kamp. Gjëja e parë që ata vizituan ishte dyqani 'Policët për Fëmijët'. "Të gjitha të hollat që mbliidhen nga ky program

janë donacion që u dedikohen shkollave dhe nxënësve të Kosovës", thotë z. Samjuëls.

Sipas z. Samuëls, nga shtatori i vitit 2000 deri në qershor 2004, shkollën e SHPK-së në Vushtrri e kanë vizituar 16,793 fëmijë, përfshirë këtu edhe 485 fëmijë serb. Fëmijët vinin nga vise të ndryshme të Kosovës, shumica prej tyre nga fshatra malorë. Kadetët e SHPK-së kishin vizituar më së 1,272 qytete dhe fshatra, kishin biseduar 38,793 fëmijë dhe kanë dhuruar 189.000 Euro. "Vizitat nëpër shkollë kanë ndihmuar që fëmijët të kuptojnë se policët janë shokët e tyre," shton z. Samjuëls. "Pikrisht këtë po bëjmë ne edhe sot".

Rraporte dhe besimi ndërtohen duke ndihmuar komunitetet

Njësitë e policisë në bashkësi gati çdo ditë është në teren. "Kur ata vizitojnë fshatrat malorë dhe u shpërndajnë fëmijëve nevojtarë xhaketa dimëri, nuk ka mënyrë më të mirë për ndërtimin e raporteve dhe besimit," thotë z. Samjuëls. "Ne bisedojmë me fëmijë për shumë çështje; trafikun, vjedhet, dëmtimet e pronave, si ta mbajmë Kosovën të pastërt dhe se si të shoqërohemi me të gjithë".

SHPK-ja është përpjekur të ndihmojë fëmijët, veçanërisht në fshatrat malorë të Kosovës ku disa fëmijë kishin ndërprerë shkollimin për shkak të kushteve ekonomike. "Ne u ndihmuam atyre të kthehen në shkollë, thjeshtë me nga një palë këpucë të reja që ata nuk kishin mundësi t'i blenin," shton me emocion z. Samjuëls. "Janë gjëra të vogla por që kanë peshë të madhe".



Fëmijët duke bërë marshin e SHPK-së, të cilët u kënaqën me 'policinë'
Fotografia:Hasan Sopa



Fotografia e përbashkët me kadetët të SHPK-së
Fotografia:Hasan Sopa

Vizita e fëmijëve vazhdoi edhe në pjesë të tjera të shkollës. Interesante ndër to ishte vizita në palestren sportive të SHPK-së, ku fëmijët për së afërmi patën rastin t'i shohin disa ushtrime psikofizike, nëpër të cilat kalon çdo kadet i SHPK-së.

Pas ngrënjes së drekës famijët u rreshtuan për herë të fundit për ta bërë marshin e SHPK-së. Të gjithë ne i'u bashangjitëm këtij marshi dhe ishte mjaft argëtuese, e sidomos për fëmijët të cilët u kënaqën me 'policët'.

Para ndarjes fotografia e përbashkët me fëmijë në hyrje të shkollës policore, e cila si kujtim do të vendoset në muret e shkollës së bashku me dy vizatime të bëra nga vetë nxënësit që i'a dhuruan shkollës.

Në fund Deil Samjuëls i'u drejtuar visitorëve të rinjë me shpresë se, kur ndërkombehtarët të largohen nga këtu, policia jonë do ta vazhdojë këtë program të mbështetur nga komuniteti. "Në çdo vend të botës fëmijët janë e ardhmja e atij vendi. Atë që ua mëson sot, ata do ta bëjnë nesër".